



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264154

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05820277

KPPP.nr. 2052/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit A.SH. B.I, me numër unik identifikues 810264086 dhe seli në Gjilan, rr. “Muharrem Ibrahim” nr. 316, kundër debitorit “Asel Naz Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811425497 dhe seli në Bablak, Komuna e Ferizajit, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj, p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 764/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 13.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Asel Naz Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811425497 dhe seli në Ferizaj, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 764/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 764/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 11-Q/2023, e datës 01.11.2023 dhe Faturës nr. B11-Q/2023, e datës 01.11.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 764/23, të datës 06.11.2023, me të cilin është urdhëruar debitori “Asel Naz Concept” Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar nga faturat,

brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 5,900.00, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e lejimit të propozimit për përbarim e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se debitori asnjëherë nuk ka pranuar nga kreditori shërbimin e përshkruar si në fatura, përkatësisht nuk ka shfrytëzuar lokalet me qira me çmimin e vendosur në fatura, sepse është tërhequr nga objektet e qirasë me datë 15.08.2023, ndërsa faturat kanë të bëjnë me qiranë e muajit nëntor 2023 që ende nuk kanë arritur për pagesë dhe se janë lëshuar në kundërshtim me kontratën e qirasë. Më tej, ka theksuar se faturat janë nënshkruar dhe pranuar me mirëbesim nga debitori në janar të vitit 2023, kur kreditori kishte lëshuar të gjitha faturat e vitit 2023 përnjëherë, mirëpo të njëjtat janë fiktive për faktin se janë lëshuar pa ndonjë mbështetje në shfrytëzimin e lokaleve me qira dhe në kontratë. Poashtu, debitori ka kundërshtuar urdhrin edhe për faktin se lidhur me faturat mbi të cilat është lejuar urdhri përbarimor është paraqitur padë për mohimin e borxhit pranë Gjykatës Komerciale duke propozuar që përbarimi të shtyhet/pezullohet deri në një vendim të gjykatës lidhur me padinë. Ndërsa, ka shtuar se në objektin e qirasë në mes palëve ka pasur një aksidenti zjarri i shkaktuar për shkak të instalimeve elektrike për çka lokali ishte bërë i pashfrytëzueshëm dhe se debitori ka njoftuar kreditorin se do të tërhiqet nga lokali me datë 31.08.2023. Në fund, ka theksuar se debitori asnjëherë nuk ka pranuar shërbimet sipas faturave prandaj të njëjtat nuk mund të cilësohen si dokumente të besueshme. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se procedurën përbarimore e ka iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas LPP-së, të cilat janë në origjinal, të nënshkruara dhe se nuk ka pasur vërejtje nga debitori për të njëjtat. Tutje, ka shtuar se debitori në prapësim ka pranuar borxhin, mirëpo që prapësimin e ka paraqitur për ta prolonguar procedurën. Duke qenë se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj, si dhe nuk ka ofruar prova me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij sipas nenit 69.4 të LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përbarimor ta vërtetojë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për

Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se përbaruesi privat ka lejuar urdhrin përbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 11-Q/2023, e datës 01.11.2023 dhe Faturës nr. B11-Q/2023, e datës 01.11.2023, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është emërtuar qartë objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se të njejtat fatura janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se detyrimet nga faturat nuk janë bërë të arritshme për pagesë pasi që kanë të bëjnë me qira për muajin nëntor të vitit 2023, mirëpo të njetjat i gjeti si të pabazuara, pasi që në faturat objekt përbarimi është përcaktuar qartë edhe afati brenda të cilit kreditori ka qenë i obliguar ta përmbush detyrimin, dhe rrjedhimisht të njetjat janë bërë të arritshme për pagesë.

Poashtu, gjykata ka vlerësuar edhe kërkesën për pezullimin e procedurës përbarimore për shkak të inicimit të procedurës kontestimore nga debitori për mohimin e borxhit sipas faturave

objekt përmbarimi, mirëpo gjeti se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e përcaktuara në nenin 65 të LPP-së, për pezullimin e kësaj procedure përmbarimore.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e debitorit se kontrata mbi qiranë është shkëputur dhe se debitori nuk ka shfrytëzuar lokalin me qira edhe për shkak të aksidentit të ndodhur të zjarrit, mirëpo gjeti se të njetat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë pasi që procedura përmbarimore i nënshtrohet paritmit të rigorozitetit formal mbi bazën e të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njetat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2052/23, datë 13.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.